

DORACAK PËR  
MËSIMDHËNËS PËR  
INTEGRIM TË  
MËSIMIT  
EKSPERIENCIAL  
RRETH MJEDISIT  
JETËSOR DHE  
NDRYSHIMEVE  
KLIMATIKE NË TË  
MËSUARIT E  
SHKENCAVE  
NATYRORE NGA  
KLSA E PARË DERI  
NË TË PESTËN TË  
ARSIMIT FILLOR

Autorë:

Kiril Arsovski-Përzho

Nikolla Neshkoski

Sllavica Nestorovska

Biljana Arsovska

Mr. Ivanka Mijiq

Mbështetje profesionale:

Dr. Natalija Aceska

Mare Bojçovska-Saveska

Bashkim Mislimi

Udhëzime për përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore:

Ivana Dvojakova

Përkthyese e gjuhës së shenjave:

Violeta Zgonc

Redaktor:

Mr. Mitko Çeshllarov

Redaktimi teknik:

Aneta Vasileva

Andrijana Zafirovska

Dizajni, ilustrimet dhe përpunimi grafik:

Vera Opashinov

Lektorimi shqip:

Lektorimi maqedonisht:

Dejan Vasilevski

Luljeta Adili Çeliku

Përkthimi shqip:

Nehim Tairi

Ky doracak është përgatitur nga Byroja për zhvillimin e arsimit dhe shoqata qytetare "Eco Logic" në kuadër të projektit "Inkurajimi i fëmijëve dhe të rinjeve në Maqedoninë e Veriut për t'u bërë shtytës të ndryshimit për të zvogëluar ndjeshmérinë e komuniteteve nga ndryshimet klimatike" i zbatuar nga UNICEF-i me mbështetje financiare të Suedisë.

## HYRJE

Një ndër segmentet shumë të rëndësishme në procesin arsimor në shkolla është arsimi për mjedisin dhe ndryshimet klimatike.

Është thelbësore që nxënësit të fitojnë njohuri për mjedisin që në moshë të hershme, të formojnë qëndrime dhe vlera për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja dhe ruajtjen e një mjedisit të shëndetshëm dhe të pastër, si dhe të ndërmarrin iniciativa dhe aktivitete për të siguruar një mjesi jetësor më të pastër dhe të shëndetshëm. Në këtë mënyrë, shoqëria do të formojë breza të ardhshëm të cilët do të edukohen përmbi mjedisin, me vetëdije më të madhe mjedisore dhe të cilët do të kujdesen me përgjegjësi për natyrën dhe botën e gjallë në të.

Në plan-programmet mësimore nga klasa e parë deri në klasën e pestë të arsimit fillor, studimi i mjedisit është i integruar në një sërë përbajtjesh, veçanërisht në kuadër të lëndës së shkencave natyrore. Për arritjen e suksesshme të rezultateve të të nxënësve, të përcaktuara në plan- programe, është e nevojshme që në klasa të realizohen aktivitete cilësore dhe kreative përmes së cilave nxënësit do të mësojnë në mënyrë eksperienciale për mjedisin dhe ndryshimet klimatike.

Doracaku për mësimdhënësit që japid lëndë të shkencave natyrore nga klasa e parë deri në klasën e pestë do t'i ndihmojë mësimdhënësit e grupit klasor dhe të lëndëve përkatëse për planifikimin dhe zbatimin e orëve në të cilat përpunohen përbajtjet për mjedisin dhe ndryshimet klimatike. Doracaku është përgatitur për të mbështetur dhe frymëzuar mësimdhënësit në punën e tyre për realizimin e një mësimdhënieje të suksesshme dhe krijuese.

Doracaku përbëhet nga 30 skenarë mësimesh për një sërë përbajtjesh nga plan-programmet mësimore të shkencave të klasës së parë deri në klasën e pestë që kanë të bëjnë me të mësuarit rreth mjedisit dhe ndryshimeve klimatike. Skenarët e orëve grupohen sipas klasave (nga klasa e parë deri në të pestën veçmas). Për çdo klasë, skenarët janë të strukturuar sipas temave që mbulojnë përbajtjen për mjedisin jetësor:

## KLASA E PARË

- Tema: Njeriu dhe trupi i njeriut

Përbajtja: Kujdesi shëndetësor

- Tema: Qeniet e gjalla

Përbajtja: Bimët

## KLASA E DYTË

- Tema: Qeniet e gjalla dhe vendbanimet e tyre

Përbajtja: Kujdesi për mjedisin jetësor

- Tema: Bimët që lulëzojnë

Përbajtja: Përçimi i ujit te bimët

- Tema: Energjia

Përbajtja: Nxehtësia

## KLASA E TRETË

- Tema: Avancimi i shëndetit

Përbajtja: Jeta e shëndetshme

- Tema: Forcat dhe lëvizjet

Përbajtja: Forcat

- Tema: Ndryshimet e materialeve

Përbajtja: Djegia

- Tema: Hapësira dhe trupat qiellorë

Përbajtja: Yjet

## KLASA E KATËRT

- Tema: Karakteristikat fizike të Tokës

Përbajtja: Kushtet e motit dhe klima; Burimet natyrore dhe mbrojtja e tyre

- Tema: Karakteristikat e kafshëve dhe bimëve, si dhe ndarja e tyre

Përbajtja: Karakteristikat e kafshëve dhe bimëve; ndarja e kafshëve dhe bimëve

## KLASA E PESTË

- Tema: Karakteristikat natyrore-gjeografike të kontinenteve

Përbajtja: Relievi i kontinenteve; Atmosfera

- Tema: Cikli jetësor i bimëve të lulëzuara

Përbajtja: Fazat e ciklit jetësor të bimëve

- Tema: Organizmat e gjalla dhe mjedisë jetësor

Përbajtja: Ndikimi i injerit në mjedisin jetësor

Çdo skenar për orën e caktuar trajton përbajtje konkrete që ndërlidhet me standartet e duhura të vlerësimit të plan-programmit që duhet të arrihen nëpërmjet aktiviteteve mësimore. Njëkohësisht, për çdo skenar ore sigurohen konceptet që duhet të përvetësojnë nxënësit. Gjithashtu, janë theksuar pajisjet dhe mijetet e nevojshme për realizimin e aktiviteteve gjatë orës mësimore.

Skenarët e orëve zhvillohen përmes aktiviteteve hyrëse, kryesore dhe përbyllëse. Aktivitetet hyrëse synojnë të aktivizojnë njohuritë e mëparshme të nxënësve dhe t'i njohin ata me përbajtjen. Ato kryesisht konceptohen duke ndjekur prezantime të përshtatshme vizuale, duke zhvilluar diskutime etj. Në pjesën që u referohet aktiviteteve kryesore, jepet një përshkrim i hollësishëm i aktivitetit përmes së cilës nxënësit do të hulumtojnë dhe mësojnë në mënyrë eksperienciale, si dhe një propozim për mënyrën e organizimit të punës së nxënësve në grupe ose në çifte, me një theks të veçantë në monitorimin dhe drejtimin e nxënësve kur bëjnë supozime, kryejnë eksperimentet, vëzhgojnë ndryshimet, regjistrojnë rezultatet, paraqesin ato, shpjegojnë dhe diskutojnë për të njëjtat. Aktivitetet e skenarit kryesor të mësimit në këtë doracak ofrojnë një gamë të gjërë idesh për të mësuar nëpërmjet kërkimit dhe veprimit krijues. Aktivitetet përfundimtare, nga ana tjetër, synojnë të nxjerrin përfundime të sakta dhe të duhura. Pjesa e fundit e skenarëve të mësimit është reflektimi, në të cilin ofrohen pyetje për të përbledhur dhe lidhur atë që është mësuar me jetën e përditshme të nxënësve, si dhe pyetje se si janë ndjerë ata gjatë mësimit dhe sa interesant ka qenë aktiviteti për ta.

Në fund të çdo skenari mësimor, jepet një link/vegëz me një version video të eksperimentit të përfshirë në aktivitetet kryesore, i cili i mundëson mësimdhënësit të ketë një pasqyrë konkrete për të organizuar dhe realizuar më mirë punën eksperimentale gjatë orës së mësimit.

Skenarët e mësimit, pjesë përbërëse e këtij doracaku, mësimdhënësit mund t'i përdorin si ide për aktivitete që do të arrijnë standartet e vlerësimit në zbatimin e përbajtjeve të sipërpërmendura të plan-programeve të shkencave natyrore. Aktivitetet mund të ndërmerren siç janë dhënë në skenarët e mësimit, ato mund të përshtaten ose modifikohen sipas ideve të mësimdhënësive, nevojave dhe interesave të nxënësve dhe përparimit të tyre në procesin mësimor, mjeteve të punës në dispozicion, kushteve në shkollë etj. Ato përfaqësojnë shembuj të shkëlqyeshëm se si mësimi me përvojë (eksperiencial) rreth mjedisit dhe ndryshimeve klimatike mund të integrohet në mësimdhëni e klasave nga klasa e parë deri në klasën e pestë sipas plan-programmit të ri.

Pritet që ky doracak, përvëç se do të jetë një mbështetje për mësimdhënësit në planifikimin dhe realizimin e mësimdhënieve, të jetë edhe një nxitje për kreativitet, motivim dhe entuziazëm edhe më të madh në punë.

### Organizimi i hapësirës dhe ambientit të punës

- Është e nevojshme të sigurohet një ambient i njohur dhe i sigurt duke hequr pengesat fizike.
- Vendi ku do të kryhet aktiviteti duhet të jetë i qasshëm, ndërsa materialet të jenë lehtësish të qasshme për t'u trajtuar.
- Duhet të reduktohen sa më shumë stimujt e jashtëm që mund të ndikojnë në shqisat dhe të shpërqendrojnë pa nevojë vëmendjen (zhurma, drita).
- Nxënësit janë të organizuar në një mënyrë që optimizon mundësitet për komunikim, ndërveprim dhe mësim për të gjithë - me fokus të veçantë te nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të cilët përballen me pengesa për të mësuar, zhvillim dhe pjesëmarrije.

### Përzgjedhja e materialeve dhe mjeteve të punës

- Si pjesë e përgatitjes merret parasysh aftësia e nxënësit për të trajtuar në mënyrë të sigurt materialet e parashikuara për realizimin e aktivitetit. Nëse nxënësi përdor materiale të personalizuara (p.sh. mbajtëse për shkumësa, mbajtëse për stilolapsa, brusha për ngjyrosje etj.), atëherë ato përdoren gjatë realizimit të aktiviteteve.
- Nëse deri më tanë nxënësi nuk ka punuar me disa nga materialet e ofruara, është e nevojshme të diskutohet me prindërit dhe anëtarët e ekipit gjithëpërfshirës për mundësinë e futjes së tyre në punën e përditshme të nxënësit.
- Fleksibiliteti dhe zbatimi i strategjisë të ndryshme janë të nevojshme gjatë punës me materiale në mënyrë që nxënësi të mund t'i manipulojë ato më lehtë (për shembull, në vend që të lyejë me kolazh, ai mund të piktuorojë ose të prodhojë në formate më të mëdha nëse studenti ka vështirësi me aftësitë motorike).

### Komunikimi

- Mësimdhënësi jep kërkesa të shkurtra dhe të thjeshta, përdor komunikimin jo verbal dhe komunikimin nëpërmjet fotove dhe videoeve.
- Nxënësit inkurajohen dhe nxiten të komunikojnë (p.sh. duke bërë pyetje të thjeshta).
- Mësimdhënësi tërheq vëmendjen e nxënësve vizualisht, verbalisht ose fizikisht.
- Nxënësit inkurajohen të mësojnë përmes komunikimit të ndërsjellë, të shkëmbenjë përvoja dhe të hulumtojnë në mënyrë të pavarur (për shembull, të shikojnë libra ose enciklopedi, të kërkojnë në internet në lidhje me temat që mbulojnë aktivitetet).
- Mësimdhënësi respekton vendimet e nxënësve.

## Udhëzime për përfshirjen e nxënësve me aftësi të veçanta arsimore në realizimin e aktiviteteve

Aktivitetet e këtij doracaku mundësojnë përfshirjen e të gjithë nxënësve, pavarësisht aftësive, kapaciteteve dhe njojurive të mëparshme. Në raste të caktuara, mësimdhënësit do të duhet të bëjnë përshtatje të caktuara të aktiviteteve. Kur vendlodhi se si të përshtatni metodat, format dhe mjetet e punës për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, është e rendësishme t'u përgjigjeni pyetjeve të mëposhtme:

- A mundet nxënësi të marrë pjesë në të njëjtën mënyrë si bashkëmoshatarët/shokët e klasës?
- Nëse nuk mundet, a mund ta bëjë aktivitetin me materiale dhe mjete të përshtatura?
- Nëse nuk mundet, a mund ta bëjë aktivitetin në çifte apo grupe të vogla?
- Nëse nuk mundet, a mund ta bëjë aktivitetin me ndihmën e herëpashershme të një të rrituri (mësimdhënësi, asistenti arsimor)?
- Nëse nuk mundet, a mund ta bëjë aktivitetin me ndihmën e drejtpërdrejtë të një të rrituri (mësimdhënësi, asistenti arsimor)?
- Nëse nuk mundet, a mund të bëjë një aktivitet tjeter që i përshtatet njojurive dhe aftësive të tij?

Përgjigja e këtyre pyetjeve jep drejtim se si të përshtaten ose modifikohen aktivitetet. Realizimi i aktiviteteve me nxënës me nevoja të veçanta arsimore nuk mund të realizohet në mënyrë të planifikuar më parë. Në raste të tillë, gjëja më e rendësishme është të ndiqni nevojat e nxënësit, brenda mundësive tuaja.

Përshtatjet ose modifikimet që do të bëhen për zbatimin e aktiviteteve duhet të bazohen në një vlerësim të mëparshëm të nxënësit, përkatesisht në potentialin, aftësitë dhe nevojat e tij për mbështetje, në përputhje me qëllimet e përcaktuara në planin individual arsimor të nxënësit ose një plan-program të modifikuar.

Më poshtë jepen udhëzime që mund të janë të dobishme në përshtatjen e hapësirës, kohës, materialeve, komunikimit dhe qasjes ndaj punës me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

### Organizimi i orarit ditor dhe përcaktimi i kohës për realizimin e aktivitetit:

- Është e dëshirueshme që prezantimi i orarit ditor të jetë vizual duke përdorur figura në mënyrë që nxënësit të dallojnë dhe kuptojnë se për çfarë aktivitetesh po bëhet fjalë.
- Fleksibiliteti është i dëshirueshëm dhe nëse nxënësi me nevoja të veçanta arsimore nuk ka mundësi të marrë pjesë për momentin, atëherë aktiviteti shtyhet nëse e lejon orari ditor.

## Vëmendja dhe përqendrimi

- Para fillimit të aktivitetit, edukatori/ja duhet të jetë i sigurt se ka vëmendjen e fëmijës. Për këtë qëllim, në tavolinë apo në hapësirë nuk duhet të ketë gjëra që do të shpërqendronin vëmendjen e fëmijës.
- Edukatori/ja ndihmon fëmijët në organizimin e hapësirës dhe materialeve.
- Koha e aktivitetit rregullohet sipas vëmendjes dhe përqendrimit të fëmijës. Nëse është e nevojshme, bëhet një pushim i shkurtër, gjatë të cilit fëmija mund të bëjë ndonjë detyrë që e relakson. Edukatori/ja shënon fillimin dhe mbarimin e pushimit dhe mandej fëmija vazhdon me detyrën.
- Përdoren kohëmatës vizualë që tregojnë se sa minuta kanë mbetur për aktivitetin.
- Vëmendja dhe përqendrimi janë një "ushtrim" sipas qasjes "hap pas hapi" gjatë zbatimit të aktiviteteve.

## Përvetësimi i nocioneve të reja

Gjatë realizimit të aktiviteteve, kur fëmijët me nevoja të veçanta arsimore ndeshen me nocione dhe koncepte të panjohura për ta, atëherë mund të zbatohen udhëzimet e mëposhtme:

- Përdoren fjalë dhe fjalë të thjeshta me mbështetje shumëshqisore (fotografi ose ilustrim, video, objekt konkret, një prodhim nga aktiviteti).
- Përdoret një kombinim i metodave të ndryshme të punës: metoda e demonstrimit, spjegimit, ilustrimit, lojës etj.
- Detyrat dhe aktivitetet ndërlidhen me përvojën e fëmijës.
- Fëmija përfshihet në diskutim, me pyetje që korrespondojnë me aftësitë dhe mënyrën e tij të komunikimit.
- Planifikohet dhe parashikohet kohë e mjafthueshme për përsëritje të koncepteve që mbulohen në orë.

## Niveli i përfshirjes dhe mbështetjes gjatë aktivitetit

- Në varësi të aftësive të fëmijës dhe interesimit të tij për aktivitetin konkret, bëhet vlerësimi se cilat aktivitete mund të kryejë në mënyrë të pavarur ose me mbështetje. Kjo mbështetje mund të ofrohet nga bashkëmoshatarët dhe/ose edukatori/ja.
- Mbështetja e bashkëmoshatarëve është mjaf e rëndësishme sepse krahas përshtatjeve apo modifikimeve të tjera, kontribuon shumë në përfshirjen më të madhe të fëmijës me nevoja të veçanta arsimore në aktivitet. Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme për fëmijët e tjerë sepse u mëson atyre ndjeshmëri, mosdiskriminim dhe barazi.
- Mbështetja e bashkëmoshatarëve mund të përfshijë: ndihmë për trajtimin e materialeve, kujtimin e hapit të ardhshëm të aktivitetit, disa spjegime në lidhje me aktivitetin etj.
- Është e nevojshme të praktikohet puna në grup të vogël ose puna në çifte, ku fëmija me nevoja të veçanta arsimore do të ketë mundësi të përfshihet dhe të ndërveprojë me bashkëmoshatarët e tij.
- Edukatori/ja përdor lavdërimin, shpërbolen dhe inkurajon fëmijën gjatë aktivitetit.

**KLASA E PARË**

TEMA: Njeriu dhe trupi i njeriut.

PËRMBAJTJA: Kujdesi për shëndetin - Matësi i ndotjes

NOCIONE QË DUHET TË MIRATOHEN:

Ajri i pastër.

NÐËRLIDHJA ME STANDARDET E VLERËSIMIT:

- E shpjegon rëndësinë e ujit të pastër dhe ajrit të pastër për shëndetin.

PAJISJET DHE MJETET E NEVOJSHME:

Secili grup/çift merr një fletë të kuqe dhe një të gjelbër, shirit vetëngjitës transparent të dyanshëm, një fllomaster, një thjerrëz, një objekt të rëndë (gur), gërshërë.



## • SKENARI I ORËS

### • AKTIVITETE HYRËSE



Nxënësit shikojnë një prezantim vizual për ajrin e ndotur dhe të pastër. Më pas ata diskutojnë se si mund të vërejnë ndotjen e ajrit.

### • AKTIVITETE KRYESORE

Nxënësit ndahen në grupe/çifte të vogla. Mësuesi/ja u jep mjetet e nevojshme për punë dhe u jep udhëzime të qarta për punën.

Nxënësit duhet të bëjnë një supozim për rezultatet që presin dhe të shpjegojnë pse mendojnë kështu. Ata i paraqesin supozimet vizualisht në fletoret e tyre.

Çdo grup/çift kryen aktivitetin.

Mësuesi/ja monitoron punën e nxënësve, i drejton dhe i ndihmon nëse është e nevojshme.

Aktiviteti:

Mësuesi/ja u shpërndan grupeve/çifteve një fletë të kuqe dhe një të gjelbër.

Fleta e kuqe përfaqëson ajrin në klasë.

Fleta e gjelbër përfaqëson ajrin e jashtëm (në oborrin e shkollës).

Nxënësit presin shiritat për së gjati nga një fije shiritit vetëngjitës. Ngjisnin nga një fije në secilën fletë.

Fleta e kuqe "Ajri në klasë" vendoset në një sipërfaqe të sheshtë pranë dritares ose në çdo vend të hapur në klasë.



Fleta e gjelbër "Ajri në oborrin shkollor" dërgohet në oborrin e shkollës, vendoset në një vend të sigurt, ndërsa një objekt i rëndë (për shembull, një gur) vendoset në një cep të fletës për të mos flutuar larg.

Fletët nuk lëvizën gjatë eksperimentit.

Fletët e vendosura në këtë mënyrë lihen të qëndrojnë në të njëjtin vend për shtatë ditë.

Nxenësit vëzhgojnë shiritat ngjitetës çdo ditë me një xham zmadhues (thjerrëz), ndërsa ndryshimet i shënojnë/vizatojnë në mënyrë vizuale në fletoret e tyre.

#### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE

Pas gjashtë-shtatë ditësh, nxenësit krahasojnë rezultatet e fituara për ajrin në klasë me ato jashtë dhe i regjistrojnë/vizatojnë në fletoret e tyre.

Ata vërejnë se sipërfaqja ngjitetëse e fletës me emrin "Ajri i jashtëm/oborri shkollor" ka më shumë grimca të ngitura në të në krahasim me sipërfaqen ngjitetëse të fletës me emrin "Ajri i klasës".

Nxenësit krahasojnë rezultatet e fituara me supozimet që kanë bërë, diskutojnë dhe arrijnë në përfundim se në ajër ka ndotës. Më pas ata përmenden ndotësit e ndryshëm që mendojnë se janë të pranishëm në ajër.

#### • REFLEKTIM


Çfarë bëmë sot?

A ju duk interesant aktiviteti?

Çfarë mësuat?

Si mund ta zbatoni atë që keni mësuar në jetën tuaj të përditishme?

Si u ndjetë në klasë? (rrethoni)



TEMA: Njeriu dhe trupi i njeriut.

PËRMBAJTJA: Kujdesi për shëndetin - Pastrimi i ujit.

NOCIONE QË DUHET TË MIRATOHEN:


Ujë i pastër, shëndet.

NÐËRLIDHJA ME STANDARDËT E VLERËSIMIT:

- E shpjegon rëndësinë e ujit të pastër dhe ajrit të pastër për shëndetin.

PAJISJET DHE MJETET E NEVOJSHME:

Për çdo grup/çift, një shishe plastike, tre-katër topa pambuku, dy copa pëlhure pambuku, gjashtë-shtatë guralecë të vegjël, ujë, dy pëllëmbë dheu, dy gota plastike.



## • SKENARI I ORËS

### • AKTIVITETE HYRËSE



Nxënësit shikojnë një prezantim vizual për rëndësinë e ujit të pastër. Pastaj ata diskutojnë se në çfarë mënyrash mund të pastrohet uji.

### • AKTIVITETE KRYESORE

Nxënësit ndahen në grupe/çifte të vogla. Grupet/çiftet marrin mjetet e nevojshme për të punuar. Më pas mësimdhënësi jep udhëzime të qarta për punën e grupeve/çifteve dhe një pëershkrim të hollësishëm e të qartë të aktivitetit.

Nxënësit duhet të bëjnë një supozim për rezultatet që presin dhe të shpjegojnë pse mendojnë kështu. Ata i paraqesin supozimet vizualisht në fletoret e tyre.

Çdo grup/çift kryen aktivitetin.

Mësuesi/ja monitoron punën e nxënësve, i drejton dhe i ndihmon nëse është e nevojshme.

Aktiviteti:

Para se të fillojë aktiviteti, mësuesi/ja pret pjesën e poshtme të shishevë plastike të ujit, më pas i jep secilit grup/çift një shishe plastike të prerë në këtë mënyrë (pjesën e sipërme të shishes).



Nxënësit vendosin qafën e shishes poshtë në tapet.

Nëpërmjet pjesës së prerë nxënësit mbushin qafën e shishes me topa pambuku.

Mbi pambukun vënë disa copa të vogla pambuku dhe mbi të vendosnin disa guralecë të vegjël.

Mësuesi/ja i jep se cilat grup një filxhan me një përzierje uji dhe dheu.

Nxënësit e derdhin përzierjen e tokës dhe ujit përmes pjesës së hapur të shishes ndërsa uji derdhet në një gotë të pastër.

#### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE

Nxënësit vërejnë një ndryshim në pastërtinë dhe çiltërsinë e ujit para dhe pas kalimit përmes filtrit të përbërë nga gurë, pélburë dhe pambuk.

Nxënësit vërejnë se materialet në shishe pastrojnë ujin nga dheu.

Nxënësit krahasojnë rezultatet e fituara me supozimet që kanë bërë. Ata diskutojnë dhe nxjerrin përfundim se uji i ndotur mund të pastrohet

#### • REFLEKTIM


Çfarë bëmë sot?

A ju duk interesant aktiviteti?

Çfarë mësuat?

Si mund të zbatoni atë që e mësuat në jetën e përditshme?

Si u ndjetë në klasë? (rrethoni)



TEMA: Gjallesa.

PËRMBAJTJA: Bimë - Karota.

NOCIONE QË DUHET TË MIRATOHEN:

Rrënje, dru, gjethë.

NDËRLIDHJA ME STANDARDET E VLERËSIMIT:

- E njeh nevojën e kujdesit të bimëve (kullotën, lulet, pemët).

PAJISJET DHE MJETET E NEVOJSHME:

Çdo grup/çift merr tre karota, një kuti të zbrazët vezësh, ujë, një dyshek të papërshkueshëm nga uji.



## • SKENARI I ORËS

### • AKTIVITETE HYRËSE



Nxënësit shikojnë një prezantim vizual për kujdesin e bimëve.

Më pas ata diskutojnë mënyrat për t'u kujdesur për bimët.

### • AKTIVITETE KRYESORE

Nxënësit ndahen në grupe/çifte të vogla. Grupet/çiftet marrin mjete e nevojshme për të punuar. Më pas mësuesi/ja jep udhëzime të qarta për punën e grupeve/çifteve, si dhe një përshkrim të hollësishëm e të qartë të aktiviteteve.

Nxënësit duhet të bëjnë një supozim për rezultatet që presin dhe të shpjegojnë pse mendojnë kështu. Ata i paraqesin supozimet në mënyrë vizuale në fletoret e tyre.

Çdo grup/çift kryen aktivitetin.


Mësuesi/ja monitoron punën e nxënësve, i drejton dhe i ndihmon nëse është e nevojshme.

Aktiviteti:

Mësuesi/ja i ndan grupeve/çifteve nga tri pjesë të karotave (vetëm majat e karotave që lidhen me gjethet).

Nxënësit vendosin copat e prera të karotave në qendër në gropat e kartonit të vezëve.

Ata vendosin kutitë e vezëve me karotat në një material/dyshek të papërshkueshëm nga uji dhe i vendosin pranë dritat e reave.



Nxënësit i ujitin karotat me një sasi të vogël uji për shtatë ditët e ardhshme (derisa ato të mbijnë). Karotat që mbijnë (fidanët) së bashku me kutinë e kartonit mbillen në kopshtin e shkollës.

Karrotat/fidanët nuk prodhojnë karota të reja në tokë, por një lule që më vonë do të prodhojë farë nga e cila mund të mbillen karota të reja.

#### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE

Nxënësit vërejnë ndryshimet që ndodhin te karotat.

Nxënësit krahasojnë rezultatet e fituara me supozimet që kanë bërë. Ata arrijnë në përfundim se pjesa e sipërme e karotës që nuk e konsumojmë, në vend që të hidhet si mbeturinë, mund të rimbillet me kujdes dhe mund të mbijë një bimë e re.

#### • REFLEKTIM

Çfarë bëmë sot?

A ju duk interesant aktiviteti?

Çfarë mësuat?

Si mund të zbatoni atë që e mësuat në jetën e përditshme?

Si u ndjetë në klasë? (rrethoni)



# KLASA E DYTË



TEMA: Gjallesat dhe vendbanimet e tyre.

PËRMBAJTJA: Kujdesi për mjedisin jetësor - Gazrat.

NOCIONE QË DUHET TË MIRATOHEN:

Mbeturinat.

NDËRLIDHJA ME STANDARDET E VLERËSIMIT:

- Njeh mënyrat e kujdesit për mjedisin dhe vendbanimet e afërta.
- Përshkruan ndikimet pozitive dhe negative të njeriut në mjedis.

PAJISJET DHE MJETET E NEVOJSHME:

Tri shishe plastike (me vëllim 0,33L), tri tullumbace, ujë, lëvozhgë bananeje, 50 gr fruta të freskëta (mbetje portokalli, limon ose manaferra).



## • SKENARI I ORËS

### • AKTIVITETE HYRËSE



Nxënësit shikojnë një prezantim vizual për ndikimin e deponive në mjedis (si ato e ndotin ajrin).

Ata diskutojnë mënyrat se si mund të zvogëlohet ndikimi negativ i mbeturinave në mjedis.

### • AKTIVITETE KRYESORE

Nxënësit ndahen në grupe/cifte të vogla. Grupet/ciftet marrin mjetet e nevojshme për të punuar. Mësuesi/ja jep udhëzime të qarta për punën e grupeve/cifteve dhe një përshkrim të hollësishëm e të qartë të aktivitetit/eksperimentit.

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të bëjnë një supozim për rezultatet që presin dhe të shpjegojnë pse mendojnë kështu.

Nxënësit shënojnë supozimet në fletoret e tyre.

Çdo grup/cift kryen aktivitetin/eksperimentin.

Mësuesi/ja monitoron punën e nxënësve, i drejton dhe i ndihmon nëse është e nevojshme.

Aktiviteti:

Mësuesi/ja u shpërndan grupeve lëvozhga bananeje dhe copa frutash të freskëta.



Nxënësit vendosin copat e lëvozhgës së bananes në një shishe.

Në shishen e dytë vendosin pjesët e mbeturat e frutave.

I mbushin dy shishet e frutave me ujë.

Shishen e tretë e mbushin vetëm me ujë.

I mbyllin grykat e shishevë me tullumbace të pafryrë.



Të tri shishet i vendosin në një vend ku ka dritë dhe nxehësi të mjaftueshme (në dritaren e klasës ose në një vend me diell në oborrin e shkollës).

Nxënësit vëzhgojnë ndryshimet në shishet e mbyllura të tullumbaceve për shtatë deri në dhjetë ditët e ardhshme.

#### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE

Nxënësit vërejnë se tullumbacet me të cilat i kanë mbyllur shishet e ujit dhe frutat e mbeturat (lëvozhga e bananes) ose copat e frutave të freskëta janë fryrë dhe tullumbacet që mbylli shishen e ujit nuk është fryrë fare.

Tullumbacija në shishen e ujit dhe lëvozhgës së bananes fryhet më shumë se tullumbacija në shishen e ujit dhe frutave. Tullumbacija e shisheve të ujit nuk është i fryrë fare.

Ata krahasojnë rezultatet me supozimet e dhëna.

Nxënësit nxjerrin përfundim se për shkak të zërthimit të frutave ose mbetjeve të frutave në ujë, fryhen tullumbacet me të cilat mbyllen shishet, përkatesisht se dekompozimi i mbetjeve lëshon substancë të dëmshme në ajër.

#### • REFLEKTIM

Çfarë bëmë sot?


A ju duk interesant aktiviteti?

Çfarë mësuat?

Si mund ta zbatoni atë që keni mësuar në jetë tuaj të përditshme?

Çfarë mund të bëhet me mbeturinat që marrim nga ushqimi?

Si u ndjitet në klasë? (rrethoni)



TEMA: Gjallesat dhe vendbanimet e tyre.

PËRMBAJTJA: Kujdesi për mjedisin jetësor - Koshi i plehrave.

NOCIONE QË DUHET TË MIRATOHEN:

Riciklim, ripërdorim, mbeturina.

NDËRLIDHJA ME STANDARDET E VLERËSIMIT:

- Përmenden materiale që mund të riciklohen dhe ripërdoren.
- Identifikon mënyra të kujdesit për mjedisin e afërt dhe vendbanimet.

PAJISJET DHE MJETËT E NEVOJSHME:

Gazeta/revista të vjetra, shirit i gjërë, ngjîtës/shirit ngjîtës, ngjîtës i nxehë (silikon), karton më i trashë, bojë me sprej/bojra tempera, letër ngjîtëse, një kosh plehrash (përdoret si model), shkop ngjîtës.



## • SKENARI I ORËS

### • AKTIVITETE HYRËSE

Nxënësit shikojnë një prezantim vizual për klasifikimin, riciklimin dhe ripërdorimin e letrës së vjetër. Ata diskutojnë se cilat materiale mund të riciklohen.

### • AKTIVITETE KRYESORE

Nxënësit ndahen në grupe/çifte të vogla. Grupet/çiftet marrin mjetet e nevojshme për të punuar. Më pas mësuesi/ja jep një përshkrim të aktivitetit dhe udhëzime të qarta për punën e grupeve/çifteve.

Çdo grup/çift kryen aktivitetin.

Mësuesi/ja monitoron punën e nxënësve, i drejton dhe i ndihmon nëse është e nevojshme.

Aktiviteti:

Nxënësit marrin një fletë gazete dhe e rrotullojnë në formë cilindri. Fundin e letrës në formë cilindri e ngjisim me ngjîtës-shkop. Ata e përsërisin procesin aq herë sa është e nevojshme për t'i shkuar përreth kovës që shërben si model. Nxënësit presin dy shirita nga shiriti i trashë vetëngjîtës, njëqind centimetra të gjatë dhe i vendosin në një sipërfaqe të sheshtë.

Ata vendosin gazetat në formë cilindri mbi fijet e shiritit të trashë vetë ngjîtës në një sipërfaqe të sheshtë afër njëra-tjetrës.

Formojnë një rrëth nga gazetat në formë cilindri dhe lidhin skajet me fijet e shiritit të trashë.



Nxënësit vizatojnë dy rrathë në karton më të trashë, duke përdorur si model pjesën e poshtme të një koshi të plehrave. Mësuesi/ja i ndihmon ata të presin rrathët nga kartoni, nëse është e nevojshme. Nxënësit ngjitin dy rrathët e kartonit me njëri-tjetrin.

Mësuesi/ja përdor ngjitësin e nxehjtë për të lidhur rrathët e kartonit në njërin skaj të cilindrit.

Nxënësit i lyejnë me ngjyra temperash koshat e formuar në këtë mënyrë dhe i shënjojnë duke vizuatuar tabelat e duhura për ndarje të mbeturinave.

### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE

Nxënësit zhvillojnë diskutim për materialet që mund të riciklohen dhe të ripërdoren.

Ata arrijnë në përfundim se me riciklimin dhe ripërdorimin e materialeve, mjedisi mbrohet nga ndotja.

### • REFLEKTIM


Çfarë bëmë sot?

A ju duk interesant aktiviteti?

Çfarë mësuat?

Si mund të zbatoni atë që e mësuat në jetën e përditshme?

Si u ndjetë në klasë? (rrethoni)



TEMA: Gjallesat dhe vendbanimet e tyre.

PËRMBAJTJA: Kujdesi për mjedisin jetësor - Penda.

NOCIONE QË DUHET TË MIRATOHEN: Mbeturinat.

NDËRLIDHJA ME STANDARDT E VLERËSIMIT:

- Shpjegon ndikimin pozitiv dhe negativ të njeriut në mjedisin jetësor.

- E shpjegon rëndësinë e ujit të nevojshëm për jetë.

PAJISJET DHE MJETET E NEVOJSHME:

filxhan/kavanoz qelqi, ujë, pendë, lëng për larje të enëve sapun i lëngshëm, zinxhir, shkophth veshi.



## • SKENARI I ORËS

### • AKTIVITETE HYRËSE

Nxënësit shikojnë një prezantim vizual për ndotjen e ujit dhe ndikimin e tij te gjallesat. Të nxitur nga mësuesi/ja, përmes pyetjeve, nxënësit japid shembuj të ndotjes së ujit, diskutojnë mënyrat e ndotjes së ujit, pasojat e ndotjes së ujit dhe efektet e démshme në botën e gjallë.

### • AKTIVITETE KRYESORE

Nxënësit ndahen në grupe/çifte të vogla. Mësuesi/ja jep udhëzime të qarta për punën e grupeve/çifteve dhe një përshtatje hollësishëm e të qartë të aktivitetit. Grupet/çiftet marrin mjetet e nevojshme për të punuar. Çdo grup/çift bën kërkime duke ndjekur udhëzimet e marra më parë nga mësuesi/ja. Para fillimit të hulumtimit, secili grup/çift bën një supozim për rezultatet e hulumtimit (për shembull: Çfarë do të ndodhë me pendën në ujin e pastër dhe çfarë do të ndodhë me ujin në të cilin kemi vendosur detergjent për larjen e enëve ose sapun të lëngshëm?), i/e cili/a e shënon atë në fletore.

Mësuesi/ja monitoron punën e nxënësve, i drejton dhe i ndihmon nëse është e nevojshme.

Aktiviteti:

Nxënësit mbushin kavanozin me ujë deri në dy të tretat e vëllimit të tij. Në njërin skaj të pendës vendosin një zinxhir (një kruese dhëmbësh) dhe e vendosin në kavanozin me ujë.

Ata vendosin disa pika lëngu për larjen e enëve/sapun të lëngshëm në shkophthin e veshit.

Duke përdorur shkopin e veshit, nxënësit aplikojnë me kujdes disa pika lëngu për larjen e enëve/sapun të lëngshëm në



ujin rreth pendës, por jo drejtpërdrejt për të.

Ata e përsërisin procesin derisa penda të fillojë të zhytet në ujë.

#### • AKTIVITETE PËRMBYLLESE

Nxënësit vërejnë se lëngu për larjen e enëve/sapuni i lëngshëm kontaminon ujin dhe shkakton fundosjen e pendës (shfaqja e një zugut). Nxënësit arrijnë në përfundimin se uji që është i ndotur me mbeturina të ndryshme, si detergjente për larjen e enëve, produkte higjienike etj., ndikon drejtpërdrejt në botën e gjallë.

#### • REFLEKTIM


Çfarë bëmë sot?

A ju duk interesant aktiviteti?

Çfarë mësuat?

Si mund të ndikojmë që të zbusim ndotjen e mjedisit?

Si u ndjetë në klasë? (rrethoni)



TEMA: Gjallesat dhe vendbanimet e tyre.

PËRMBAJTJA: Kujdesi për mjedisin jetësor - Dheu.

NOCIONE QË DUHET TË MIRATOHEN:


Mbeturinat.

NDËRLIDHJA ME STANDARDET E VLERËSIMIT:

- Shpjegon ndikimin pozitiv dhe negativ të njeriut në mjedisin jetësor.

PAJISJET DHE MJETET E NEVOJSHME:

Kavanoz/akuarium i madh qelqi, rërë, ujë, tri gota plastike, tri ngjyra të ndryshme ushqimore, shiringë mjekësore



## • SKENARI I ORËS

### • AKTIVITETE HYRËSE



Nxënësit shikojnë një prezantim vizual për ndotjen e tokës dhe ndikimin e tij tek gjallesat.

Pastaj diskutojnë mënyrat se si mund të ndotet toka, ndikimi i ujit të ndotur dhe efekti i dëmshëm në botën e gjallë

### • AKTIVITETE KRYESORE

Nxënësit ndahen në grupe/çifte të vogla. Grupet/çiftet marrin mjetet e nevojshme për të punuar. Mësuesi/ja jep udhëzime të qarta për punën e grupeve/çifteve dhe një përshkrim të hollësishëm e të qartë të aktiviteteve.

Para fillimit të aktivitetit mësuesi/ja u kërkon nxënësve të jalin supozimet e tyre për rezultatet që presin dhe të shpjegojnë pse mendojnë kështu. Ata i shënojnë supozimet në fletoret e tyre.

Çdo grup/çift kryen aktivitetin.

Mësuesi/ja monitoron punën e nxënësve, i drejton dhe i ndihmon nëse është e nevojshme.

Aktiviteti:

Nxënësit vendosin rërë në kavanozin/akuarumin e qelqit, por nuk e mbushin tepër.

Nxënësit mbushin tri gota me ujë deri në gjysmën e vëllimit të tyre.

Në çdo gotë me ujë vendosin një ngjyrë të ndryshme ushqimore dhe e përzgjedhë mirë.

Nxënësit e marrin një gotë dhe e hedhin gradualisht ujin me ngjyrë mbi rërë.

E njëjtë procedurë përsëritet me dy gotat e mbeturë.



Nxënësit, me ndihmën e një shiringe mjekësore, nxjerrin ujin mbi rërë dhe vëzhgojnë ndryshimet që kanë ndodhur në rërë.

#### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE

Nxënësit vërejnë se rëra ngjyroset nga uji i ngjyrosur i cili vepron si ndotës.

Nxënësit arrijnë në përfundim se uji i ndotur depërtón në tokë, si dhe në bimë (të cilat përdoren si ushqim) dhe në këtë mënyrë ka ndikim të dëmshëm në botën e gjallë.

#### • REFLEKTIM


Çfarë bëmë sot?

A ju duk interesant aktiviteti?

Çfarë mësuat?

Si mund të zbatoni atë që e mësuat në jetën e përditshme?

Si u ndjetë në klasë? (rrethoni)



TEMA: Bimë që lulëzojnë.

PËRMBAJTJA: Përçimi i ujit nëpër bimët - Ngjyrosja e luleve të bardha.

NOCIONE QË DUHET TË MIRATOHEN:


Rrënje, përcjim uji, thithje uji.

NDËRLIDHJA ME STANDARDET E VLERËSIMIT:

- Identifikon pjesët e bimës përmes së cilave përçohet uji.
- Përshkruan se si përçohet uji nëpër bimën.

PAJISJET DHE MJETËT E NEVOJSHME:

Çdo çift/grup merr pesë lule të bardha nga një bimë që lulëzon, pesë gota plastike, një litër ujë, ngjyra të ndryshme ushqimore, gëershërë.



## • SKENARI I ORËS

### • AKTIVITETE HYRËSE



Nxënësit shikojnë një prezantim vizual të përcimit të ujit nëpër një bimë. Më pas ata diskutojnë se si përçohet uji nëpër bimën, duke identifikuar pjesët e bimës përmes së cilave përçohet uji.

### • AKTIVITETE KRYESORE

Nxënësit ndahen në grupe/çifte të vogla. Grupet/çiftet marrin mjetet e nevojshme për të punuar. Më pas mësuesi/ja jep udhëzime të qarta për punën e grupeve/çifteve dhe një përshkrim të hollësishëm e të qartë të aktivitetit.

Nxënësit duhet të bëjnë një supozim për rezultatet që presin dhe të shpjegojnë pse mendojnë kështu. Ata i shënojnë supozimet në fletoret e tyre.

Çdo grup/çift kryen aktivitetin.

Mësuesi/ja monitoron punën e nxënësve, i drejton dhe i ndihmon nëse është e nevojshme.


Aktiviteti:

Nxënësit mbushin pesë gota me ujë. Një e treta e vëllimit të çdo gotë mbushet.

Në çdo gotë shtihet ngjyrë e ndryshme ushqimore.

Nxënësit presin kërcellet e luleve me gëershërë dhe vendosin nga një lule në çdo gotë.

Nxënësit i lënë lulet në gota për 24 orë.



#### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE

Ata i lënë lulet në gata me ujë të ngjyrosur të qëndrojnë për 24 orët e ardhshme.

Gjatë dites dhe të nesërmen, nxënësit bëjnë vëzhgime dhe monitorojnë nëse dhe si do të ngjyrosen lulet e bardha.

Pas një dite, nxënësit krasojnë rezultatet e fituara me supozimet që kanë bërë dhe i regjistrojnë ato. Ata zhvillojnë diskutim dhe nxjerrin përfundim.

#### • REFLEKTIM


Çfarë bëmë sot?

A ju duk interesant aktiviteti?

Çfarë mësuat?

Si mund të zbatoni atë që e mësuat në jetën e përditshme?

Si u ndjetë në klasë? (rrethoni)



**TEMA:** Bimë që lulëzojnë.

**PËRMBAJTJA:** Përçimi i ujit nëpër bimët - Karota.

**NOCIONE QË DUHET TË MIRATOHEN:**

Rrënje, përcjim uji, thithje uji.

**NDËRLIDHJÀ ME STANDARDET E VLERËSIMIT:**

- Identifikon pjesët e bimës përmes së cilave përçohet uji.

**PAJISJET DHE MJETET E NEVOJSHME:**

- Çdo grup/çift merr një karotë, një kavanoz, ngjyrosje ushqimore dhe ujë.



## • SKENARI I ORËS

### • AKTIVITETE HYRËSE

Nxënësit shikojnë një prezantim vizual për absorbimin dhe përcimin e ujit nëpër një bimë. Më pas ata diskutojnë se si uji absorbohet dhe përçohet nëpër bimë, duke identifikuar pjesët e bimës përmes të cilave uji absorbohet dhe përçohet.

### • AKTIVITETE KRYESORE

Nxënësit ndahen në grupe/çifte të vogla. Grupet/çiftet marrin mjetet e nevojshme për të punuar. Më pas mësuesi/ja jep udhëzime të qarta për punën e grupeve/çifteve dhe një përshkrim të hollësishëm e të qartë të aktivitetit.

Nxënësit duhet të bëjnë një supozim për rezultatet që presin dhe të shpjegojnë pse mendojnë kështu. Ata i shënojnë supozimet në fletoret e tyre.

Çdo grup/çift kryen aktivitetin.




Mësuesi/ja monitoron punën e nxënësve, i drejton dhe i ndihmon nëse është e nevojshme.

Aktiviteti:

Nxënësit mbushin një kavanoz me ujë deri në një të tretën e vëllimit të tij.

Shtojnë ngjyrë ushqimore në kavanozin me ujë.

Nxënësit vendosin karotën në kavanoz.



### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE

Ata e lënë karotën të qëndrojë në ujin e ngjyrosur për 24 orët e ardhshme.

Gjatë ditës dhe të nesërmen nxënësit bëjnë vëzhgime dhe ndjekin se çfarë ndodh me karotën.

Të nesërmen mësuesi/ja i pret përgjysmë karotat e të gjitha grupeve/cifteve.

Nxënësit krahasonjnë rezultatet e marra me supozimet që kanë bërë dhe i regjistrojnë ato. Ata zhvillojnë diskutim dhe nxjerrin përfundim. Gjithashtu, vërejnë se tufat përcuese të ujit e ngjyrosin karotën me ngjyrën e ujit në kavanoz. Nxënësit nxjerrin përfundim se si karota absorbon ujin (të pastër ose të ndotur) dhe përçon ujin e pastër ose të ndotur.

### • REFLEKTIM


Çfarë bëmë sot?

A ju duk interesant aktiviteti?

Çfarë mësuat?

Si mund të zbatoni atë që e mësuat në jetën e përditshme?

Si u ndjetë në klasë? (rrethoni)



## TEMA: Energjia

PËRMBAJTJA: Ngrohja - Termometri.

NOCIONE QË DUHET TË MIRATOHEN:

Nxehtësia, trup më i ngrohtë/më i ftohtë, temperatura, termometër.

NDËRLIDHJA MË STANDARDDET E VLERËSIMIT:

- Identifikon nxehtësinë si energji që ngrohet trupat dhe objektet.
- Shpjegon si ndërlidhen temperatura dhe nxehtësia e trupave.
- Mat, lexon dhe krahason temperaturën me një termometër digjital.

PAJISJET DHE MJETET E NEVOJSHME:

Enë plastike me grykë të gjerë, karton, bojëra uji/letër me ngjyra, ujë, llambë e rregullt, termometër digjital.



### • SKENARI I ORËS

#### • AKTIVITETE HYRËSE



Nxënësit shikojnë një prezantim vizual për diellin si burim energjje, përkatesisht dritën dhe nxehtësinë. Nxënësit diskutojnë për mënyrat se si mund të matim ngrohjen e trupave, si dhe ndikimin e nxehtësisë në botën e gjallë.

#### • AKTIVITETE KRYESORE

Nxënësit ndahen në grupe/çifte të vogla. Grupet/çiftet marrin mjetet e nevojshme për të punuar. Më pas mësuesi/ja jep udhëzime të qarta për punën e grupeve/çifteve dhe një përshkrim të hollësishëm e të qartë të aktivitetit.

Çdo grup/çift kryen aktivitetin.

Mësuesi/ja monitoron punën e nxënësve, i drejton dhe i ndihmon nëse është e nevojshme.



Aktiviteti:

Nxënësit mbushin katër enë plastike identike me ujë deri në gjysmën e vëllimit të tyre. (Është e rëndësishme që enët të jenë të njëjtë dhe të vendoset e njëjtë sasi uji në të katër enët).

Nxënësit me gërshtë presin me kujdes katër rrathë kartoni me diametër të barabartë me diametrin e hapjes së enëve plastike/sipërfaqja e lirë e ujit.

Katër rrathët e kartonit lyen ose mbulohen me të njëjtin material në katër ngjyra të ndryshme: e bardhë, e zezë, e verdhë dhe gjelbër.

Rrathët e kartonit vendosen në sipërfaqen e ujit në enë (për të notuar).



Nxënësit vendosin enët nën rrezet e diellit ose dritën e një llambe të zakonshme (në rolin e Diellit) dhe i lënë për rreth 15 minuta. Nxënësit diskutojnë dhe bëjnë supozime për ndryshimet që ndodhin në ujë nën ndikimin e nxehësisë si energji.

Pas 15 minutash, nxënësit heqin rrathët e kartonit dhe përdorin një termometër digital për të matur temperaturën e ujit në se cilën enë. Rezultatet e matjeve i regjistrojnë në fletoret e tyre, në tabelë ose diagram.

#### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE

Nxënësit analizojnë dhe vërejnë ndryshimin e temperaturave të matura të ujit në enët e ndryshme dhe e lidhin ndryshimin me ngjyrat e ndryshme të rrathëve të kartonit që mbulanin ujin në enët e ndryshme.

Nxënësit vërejnë se temperatura e ujit në enët e mbuluara me ngjyrë më të errët (e zezë) është dukshëm më e lartë se temperatura e ujit në enët e mbuluara me ngjyrë më të çelur (e bardhë, e verdhë dhe gjelbër). Ata diskutojnë lidhjen ndërmjet temperaturës dhe nxehësisë së trupave/ujit. Nxënësit arrijnë në përfundim se ngjyra e errët tërheq më shumë energji/nxehësi nga dielli/llamba sesa ngjyra e çelur. Nxënësit arrijnë në përfundim se ngjyra e gjelbër, e cila është ngjyra e bimëve, tërheq më pak nxehësi sesa ngjyrat e errëta, e cila gjë po e ftoh tokën.

#### • REFLEKTIM

Çfarë bëmë sot?

A ju duk interesant aktiviteti?

Si mund këtë ta zbatoni në jetën e përditshme?

Çfarë mësuat?

Si u ndjetë në klasë? (rrethoni)



TEMA: Energjia

PËRMBAJTJA: Ngrohja - Brigjet.

NOCIONE QË DUHET TË MIRATOHEN:

Nxehtësia, shkrirja.

NDËRLIDHJA ME STANDARDET E VLERËSIMIT:

- E identifikon nxehtësinë si energji që i ngroh trupat dhe objektet.

PAJISJET DHE MJETET E NEVOJSHME:

Dy enë plastike transparente identike, glinamol/plastelinë, kube akulli, një llambë e zakonshme.



## • SKENARI I ORËS

### • AKTIVITETE HYRËSE

Nxënësit shikojnë një prezantim vizual rrëth shkrirjes së akullit polar të Tokës dhe rritjes së nivelit të detit.

Nxënësit diskutojnë se si rritja e nivelit të detit ndikon në sipërfaqen e Tokës.

### • AKTIVITETE KRYESORE

Nxënësit ndahen në grupe/çifte të vogla. Grupet/çiftet marrin mjetet e nevojshme për të punuar. Mësuesi/ja jep udhëzime të qarta për punën e grupeve/çifteve dhe një përshkrim të hollësishtëm e të qartë të aktivitetit.

Çdo grup/çift kryen aktivitetin/eksperimentin.

Mësuesi/ja monitoron punën e nxënësve, i drejton dhe i ndihmon nëse është e nevojshme.

Aktiviteti:

Nxënësit, në dy enët plastike, përgjatë njërisë anë të brendshme të enës, formojnë një "breg" të vogël prej balte/plastelinë që duhet të simulojë një vijë bregdetare. (Është e rëndësishme që "bregu" i formuar në të dy enët të jetë i njëjtë.)

Nxënësit vendosin të njëjtën sasi uji të përzier me akull në gjysmat e zbrazëta të enëve plastike, deri në buzë të "bregut". Në një enë vendosin disa kuba akulli në sipërfaqen e "bregut".

Të dy enët lihen nën dritën e një llambë të zakonshme ose drejtpërdrejt në rezet e diellit, derisa akulli të shkrihet plotësisht.



Para se të fillojë shkrirja e akullit, mësuesi/ja u kërkon nxënësve të japid supozimet e tyre për rezultatet e pritura dhe shpjegimin e tyre.

Nxënësit shënojnë supozimet e tyre në një fletore.

Nxënësit vërejnë ndryshimin e niveleve të ujit në të dyja enët.

#### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE

Nxënësit vërejnë se niveli i ujit në enën me akull në sipërfaqen e "bregut" është më i lartë se niveli i ujit në enën tjetër.

Nxënësit arrijnë në përfundim se shkrirja e akullit nga polet ndikon në ndryshimin e nivelit të ujit në brigjet e Tokës dhe të botës së gjallë.

#### • REFLEKTIM


Çfarë bëmë sot?

A ju duk interesant aktiviteti?

Si ndikon ndryshimi i nivelit të ujit në bregdet në jetën e njerëzve?

Çfarë mësuat?

Si u ndjetë në klasë? (rrethoni)



TEMA: Energjia

PËRMBAJTJA: Ngrohja - Shkrirja e akullit.

NOCIONE QË DUHET TË MIRATOHEN:

Nxehtësia, shkrirja, avullimi.

NDËRLIDHJA ME STANDARDET E VLERËSIMIT:

- Përshkruan ndryshimet (shkrirjen, avullimin) që ndodhin gjatë ngrohjes.

PAJISJET DHE MJETËT E NEVOJSHME:

Enë transparente, enë rezistente ndaj zjarrit për ngrohjen e ujit, kuba akulli, pjatë elektrike për ngrohje (sobë me një pjatë).



## • SKENARI I ORËS

### • AKTIVITETE HYRËSE



Nxënësit shikojnë një prezantim vizual rrëth shkrirjes dhe avullimit të ujit në natyrë.

Më pas ata diskutojnë se si mund të shkrihet kubi i akullit e mandej të avullojë ujin.

### • AKTIVITETE KRYESORE

Nxënësit ndahen në grupe/çifte të vogla. Grupet/çiftet marrin mjetet e nevojshme për të punuar. Mësuesi/ja jep udhëzime të qarta për punën e grupeve/çifteve dhe një përshkrim të hollësishëm e të qartë të aktivitetit.

Mësuesi u kërkon nxënësve të bëjnë një supozim për rezultatet e pritura dhe të shpjegojnë pse mendojnë kështu. Ata i shënojnë supozimet në fletoret e tyre.

Çdo grup/çift kryen aktivitetin/eksperimentin.

Mësuesi/ja monitoron punën e nxënësve, i drejton dhe i ndihmon nëse është e nevojshme.

Aktiviteti:

Nxënësit vendosin disa kuba akulli në enën e pastër. Ena transparente me akull qëndron në një dhomë në temperaturë ambienti, ndërsa nxënësit vëzhgojnë ndryshimet që ndodhin në akull, përkatësisht shkrirjen e akullit.

Ujin e kubeve të shkrira të akullit e hedhin në enën rezistente nga zjarri.

Mësuesi/ja vendos enën rezistente nga zjarri në sobë dhe ngroh ujin.



### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE

Nxënësit vërejnë se kubat e akullit shkrihen gradualisht në temperaturën e dhomës.

Nxënësit vërejnë se uji i enës rezistente nga zjarri pas ngrohjes ka avulluar.

Nxënësit verifikojnë saktësinë e supozimeve të tyre.

Nxënësit arrijnë në përfundim se uji ndryshon gjendjen e tij kur nxehet.

Nxënësit diskutojnë dhe arrijnë në përfundim se Dielli si burim i nxehtësisë ndikon në gjendjen e ujit dhe se periudhat e zgjatura me diell dhe rritja e temperaturave në Tokë ndikojnë negativisht për lumenjtë, liqenet, detet dhe oqeanet.

### • REFLEKTIM


Çfarë bëmë sot?

A ju duk interesant aktiviteti?

Çfarë mësuat?

Si mund të zbatoni atë që e mësuat në jetën e përditshme?

Si u ndjetë në klasë? (rrethoni)



# **KLASA E TRETË**



TEMA: Avancimi i shëndetit.

PËRMBAJTJA: Jeta e shëndetshme - Spinaqi.

NOCIONE QË DUHET TË MIRATOHEN:

Të ushqyerit e shëndetshëm.

NDËRLIDHJA ME STANDARDDET E VLERËSIMIT:

- Endërlidh shëndetin me higjienën e ushqimit (pastrimi, paketimi dhe ruajtja e sigurt).

PAJISJET DHE MJETET E NEVOJSHME:

Gjethe të freskëta të gjelbra spinaq/marula, detergjent për larjen e enëve, zbardhues, uje, letër kuzhine, dyshek pune, doreza, syze sigurie.



## • SKENARI I ORËS

### • AKTIVITETE HYRËSE

Nxënësit shikojnë një prezantim vizual rreth ushqimeve të shëndetshme dhe mënyrave se si frutat dhe perimet mund të kontaminohen dhe zhvillojnë diskutim.

### • AKTIVITETE KRYESORE

Nxënësit ndahen në grupe/çifte të vogla. Grupet/çiftet marrin mjetet e nevojshme për të punuar. Më pas mësuesi/ja jep udhëzime të qarta për punën e grupeve/çifteve dhe një përshkrim të hollësishëm e të qartë të aktivitetit.

Çdo grup/çift kryen aktivitetin.

Mësuesi/ja monitoron punën e nxënësve, i drejton dhe i ndihmon nëse është e nevojshme.

Aktiviteti:

Mësuesi/ja përgatit një tretësirë uji dhe detergjenti në një raport vëllimi 50 : 50 (1:1) dhe një tretësirë uji dhe zbardhues në një raport vëllimi 60 : 40 (3 : 2).

Në një letër kuzhine të vendosur në një dyshek të papërshkueshëm nga uji, nxënësit vendosin në një distancë të barabartë tre gjethë spinaq/marule.

Nxënësit me doreza mbrojtëse dhe syze mbrojtëse nën mbikëqyrjen e mësuesit derdhin pikat:



- në gjethen e parë dhjetë pika ujë;
- në gjethen e dytë, dhjetë pika tretësirë uji dhe detergjenti;
- në gjethen e tretë, dhjetë pika tretësirë uji dhe zbardhues. I mbulojnë gjethet me letër kuzhine dhe i lënë në temperaturë ambienti për 24 orë.

#### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE

Pas periudhës së kaluar, nxënësit vërejnë me sa vijon:

- gjethja e trajtuar me ujë është e pandryshuar;
- gjethja e trajtuar me një tretësirë ujore të detergjentit për larjen e enëve është e butë dhe gjysmë e kalbur;
- gjethja e trajtuar me tretësirë ujore zbardhuesi është më e bardhë dhe e tharë.

Nxënësit arrijnë në përfundim se frutat dhe perimet që përdorim për ushqim të shëndetshëm mund të ekspozohen ndaj ndotësve të jashtëm dhe se ndotja ndikon në cilësinë e tyre.

Nxënësit arrijnë në përfundim se ushqimi i kontaminuar ka ndikim të dëmshëm në shëndetin e njeriut.

#### • REFLEKTIM

Çfarë bëmë sot?

A ju duk interesant aktiviteti?

Çfarë mësuat?

Si mund ta zbatoni atë që keni mësuar në jetën tuaj të përditshme?

Si u ndjetë në klasë? (rrethoni)



**TEMA:** Fuqitë dhe lëvizjet.

**PËRMBAJTJA:** Fuqitë - Mulli me erë.

**NOCIONE QË DUHET TË MIRATOHEN:** Forca, drejtimi i lëvizjes, orientimi i lëvizjes, përshpejtimi, ngadalësimi, rezistenca e ajrit.

**NDËRLIDHJA ME STANDARDET E VLERËSIMIT:**

- Shpjegon përshpejtimin dhe ngadalësimin si një ndryshim në shpejtësinë e lëvizjes.
- Identifikon rezistencën e ajrit dhe rezistencën ndaj ujit si fërkim dhe i lidh ato me formën e një trupi të caktuar.

